

Idaete SINANI

FJALË TË RRALLA NË TË FOLMEN E REKASVE TË RRETHIT TË SHKUPIT

Abstrakt: Në punim kemi trajtuar leksikun e fshatrave të rrethit të Shkupit me prejardhje nga Reka e Epërme e Gostivarit. Jemi përqendruar te fjalët e rralla autentike rekase, që përdoren në të folmen shqipe të fshatrave të Rekës dhe fshatrave me prejardhje nga kjo krahinë. Qëllimi kryesor i këtij punimi, është shqyrtimi i leksikut të kësaj të folmeje e cila ka ruajtur mjaft karakteristika të gjendjes së hershme të shqipes në tërësi, por, gjithashtu, edhe si një e folme që ka dhënë e ka marrë me të folme të tjera të krahinave përreth. Për shkak të studimeve të pakta për leksikun e fshatrave në fjalë, dhe në përgjithësi për të folmet e fshatrave të shpërngulura nga Reka, ky punim do të paraqet një ndihmesë modeste për leksikologjinë dhe leksikografinë shqiptare, për dialektologjinë dhe veçmas për përshkrimin e të folmeve të fshatrave të kësaj zone gjuhësore. Për mbarështrimin e këtij punimi, përveç konsultimit të literaturës shkencore dhe fjalorëve të ndryshëm, më së shumti jemi mbështetur në materialin e vjelë në terren si dhe në hulumtime e punime të tjera dialektore për të folmen në fjalë.

Fjalë çelës: e folme, fjalor, leksik, fshatra, fjalë të rralla, Reka e Epërme.

"Dialekti është gurra e gjallë e popullit, se aty janë fshehur thesaret e gjuhës" - Kostaq Cipo

Të folmet dialektore janë pasqyrë e historisë së gjuhës ose thënë më saktë, janë pasqyrë e historisë së vetë popullit që flet atë gjuhë. Ato paraqesin gjurmë përmes të cilave shkohet në thellësi deri tek rrënjët e gjuhës, aty ku janë gurët e themelit, mbi të cilët qëndron kjo ngrehinë e mrekullueshme e njerëzimit, e ruajtur në shekuj e mijëvjeçarë dhe e zhvilluar e përpunuar në rrjedhat e kohës.^{xi}

Fjalët dhe frazeologjia popullore, si pasuri kulturore e përbashkët kombëtarë, përbëjnë bërthamën e leksikut të gjuhës së sotme letrare. Ky thesar i çmuar është shpirti i identitetit tonë kombëtar i cili i dha jetë dhe e mban të gjallë gjuhën standarde shqipe.

Të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut, kanë ruajtur një fond të pasur e të mëvetësishëm fjalësh dhe shprehjesh të bukura popullore, që fatkeqësisht nuk kanë arritur të bëhen pronë e gjuhës sonë letrare kombëtare.

E folmja shqipe e Rekës së Epërme, një gegërishte e bukur dhe e pastër, ruan në gjirin e saj, pasuri të mëdha, që përbëjnë një thesar jo vetëm për krahinën, por edhe për vetë shqipen dhe historinë e saj. Karakteri konservativ i kësaj të folmeje, lidhet me historinë e kësaj krahine, e cila, e strukur në vetvete dhe e vendosur për t'u bërë ballë furive e rrebesheve armike të njëpasnjëshme, ka mundur të ruajë thuajse të paprekur, visarin e trashëguar të gjuhës së të parëve.

Fshatrat e rrethit të Shkupit si Gërçeci, Krushopeku, Saraji, Nerezi, Çifliku, Satapetka, Jabollca, Černivori dhe Patishka Reka, me origjinë nga Reka dhe krahina e Rekës së Epërme në

përgjithësi, në leksikun e tyre, kanë një fond të pasur fjalësh të shumta e të ndryshme për nga forma dhe nuancat kuptimore, shprehjesh frazeologjike dhe fjalësh të ashtuquajtura “të rralla”, që janë karakteristike për këtë të folme.

Nga fondi leksikor i të folmes rekase të fshatrave të rrethit të Shkupit, kemi përzgjedhur disa nga këto fjalë të rralla, për të cilat mendojmë se do të jenë në interes për leksikologjinë, leksikografinë dhe dialektologjinë shqiptare në përgjithësi.

Fjalët që do të japim në vazhdim, janë fjalë që janë përdorë në të kaluarën dhe vazhdojnë të përbëjnë leksikun aktiv të vendbanimeve të lartpërmendura.

Një numër i madh fjalësh, sipas fjalorëve etimologjik, janë fjalë të brumit të shqipes, të cilat dëshmojnë trashëgiminë e hershme të ruajtur brez pas brezi. Fjalët e tjera, janë huazime, të cilat janë dëshmi e gjallë e kontakteve të shumta e të vazhdueshme të kësaj popullate me kombe e popuj të tjerë që lanë gjurmët e tyre në historinë dhe gjuhën e shqiptarëve të kësaj krahine.

Duke përdorë fjalorin etimologjik të Kolec Topallit, kemi vënë re se fjalët që janë të huaja, janë me prejardhje nga arabishtja, persishtja, turqishtja, gjuhët sllave dhe gjuhë të tjera.

Fjalët janë të fushave të ndryshme të jetës materiale e mendore, duke na dhënë njohuri për të kaluarën dhe të tashmen, për mënyrën e jetesës, botëkuptimin dhe jetën shpirtërore, për karakterin e njeriut, për jetën familjare, për besimin, mitet dhe besëtytnitë. Na japin shpjegime për punën, ushqimin, veshmbathjet, veglat e punës, armët, bimët, kafshët e egra e shtëpiake, shpendët dhe gjithçka që lidhet me jetën e banorëve të kësaj ane.

Jemi përpjekur që fjalët t’i japim sipas rendit alfabetik, duke dhënë sqarime për secilën fjalë veç e veç, për kuptimin, etimologjinë, format e ndryshme si dhe shembuj nga e folmja.

Siç e thamë edhe më lart se e folmja e Rekës është shumë pak e studiuar, në leksikun e saj ka mjaft fjalë të cilat janë me etimologji të errët ose të panjohur deri më tash.

Abdavi:c,-a *emër f.* “grua e ve, vejushë”. Në disa fshatra, këtë fjalë e gjejmë edhe si *avdavi:c*. Mendohet të jetë huazim sllav për shkak të ngjashmërisë me fjalët sllave **udovica** dhe **vdovica**. Sipas të dhënave që kemi mbledhur në terren, kjo fjalë mund të rrjedh edhe nga emri *Abdavi:c*, gruaja e *Abdiut* e cila ka ngelë e vejë. *Ka mbetë e vejë si Abdavica. Ka mbetë abdavi:c.*

Agël, *ndajf.* “krejt, krejt i vetëm, e vetme, i tëri, i gjithi”. Në të folmen e fshatrave të Rekës, kjo ndajfolje ka një përdorim të madh edhe sot e kësaj dite. Si p.sh. *E la:n agël ve:t* (E lanë të vetëm). *Pi frige u kishte bo agël i ve:rdh* (Nga frika ishte zverdhë i tëri). *Dukej agël i kujś* (Dukej krejt i kuq).

Amçanik,-i, *emër m.* Supozohet të jetë fjalë me prejardhje sllave. Rrjedh nga fjala **omča**, që do të thotë nyje, mbërtheckë. Lidhëzat e opingave. Lidhëzat e çorapeve të leshta. *Ju ka zgi:dh amçaniki* (I është zgjidhur lidhësja).

Anteri,-a *emër f.* “petk i gjatë burrash e grash”. Është fjalë e huazuar nga turqishtja, por me burim prej arabishtes që ka hyrë edhe në gjuhë të tjera ballkanike.^{xi} Në disa fshatra të arealit gjuhësor të Rekës, anteria ka qenë një lloj fundi që ua kanë veshë fëmijëve të vegjël.

Argaç,-i *emër m.* “vend ku qëndrojnë dhentë gjatë stinës së verës, vend i rrethuar dhe i pambuluar”. Fjala **argaç**, është fjalë turke që ka kuptimin punë në vek. Në të folmen tonë, ka kuptimin vathë e bagëtive në bjeshkë. *Dulën dhent pi argaçi* (Dolën dhentë nga vatha).

Asë:m,-a emër, f. “pjergull”. Në të folmen e fshatrave rekase, kjo fjalë ka kuptimin e pjergullës së rrushit, hardhisë. Është fjalë e huazuar nga turqishtja, **asma**, që do të thotë hardhi rrushi. Është rrush asme. (Është rrush pjergulle). Ky emër haset edhe në disa të folme tjera shqipe por me kuptimin armik.

Arxhavell,-i emër m. “lloj gjelle verore që përgatitet me qepë, specë dhe domate”. *Kum bo arxhavell për dre:k* (Kam bërë gjellë vere për drekë).

Askaru:shk,-a emër f. “lloj fruti, vosë që piqet në periudhën e vjeshtës; i përngjan dardhës por fytyrë e tij janë shumë më të vogla se dardha”. *A dan askarushka t’buta* (A dëshiron vosa të buta). Pasi kemi të bëjmë me një fjalë shumë të rrallë, nuk kemi gjetur të dhëna për etimologjinë e kësaj fjale.

Azhder,-i, Azhderha emër m. “kuçedër, i madh, i fortë, i fuqishëm”. *I madh ishte sa ni azhderha* (Ishte i madh sa një kuçedër). Është huazim oriental me prejardhje perse, **ejderha**, që ka kuptimin kuçedër, dragua.

Baballak,-i emër m. “toka, pasuria e patundshme që u lihet trashëgim nga babai”. *Arën e madhe e ka baballak* (Arën e madhe e ka pasuri nga babai). Është huazim nga turqishtja, **baba, babalık**.

Baç,-i emër m. “stopan, stanar, personi që përgatit bulmetin në stanet e bjeshkëve”. Edhe pse me një përdorim të kufizuar, kjo fjalë vazhdon të jetë pjesë e leksikut të fshatrave të lartpërmendura.

Bafçar:k,-a emër f. “përparëse, skutaç”. Përdoret më tepër për përparëset që janë pjesë e veshjeve kombëtare. *Bafçarka* e veshjes së Patishka Rekës.

Bagërdar,-i emër m. “ushqim i bërë me miell misri dhe i zier në kusi, kaçamak”. *Bagërdar i kallambojt* (Kaçamak misri).

Batak,-i emër m. “vend me baltë e me ujë”. Është huazim nga turqishtja **batak** “ligatë, pellg”.^{xi} Dhe i lagur, lloç, baltë. *Ishte batak i madh* (Ishte lloç i madh).

Bastërdis folje. “kopjon modelin”. *Bastë:rdis jurrnekin*. Është metodë që përdoret nga vajzat gjatë punimit të pajës së nusërisë. Kopjimi i luleve të modelit me anë të letrës së lakmuesit ose me ndonjë letër tjetër që lëshon ngjyrë. *I bastërdisa pquhurat* (I bëra me model pëlhurat). Edhe kjo fjalë rrjedh nga folja turke **bastirmek**, që ka kuptimin shtypë.

Bofçet e nuses do t’i çojm për shyqyrrni:c (Bohçet e nuses do t’i dërgojmë në gazmendin e fejesës).

Bullçi,-ni emër m. “pjesa e brendshme e zgavrës së gojës”, aq ushqim sa merr një anë e gojës, një bulçi bukë, ujë, gllënjë”. *I kishte mbushë bullçijnt sa sën folte*. (I kishte mbushur bulçitë sa s’mundte të flasë). Etimologjia e kësaj fjale është e paqartë edhe në fjalorin etimologjik të shqipes.

Bu:lk,-a emër f. “flokët e ngritura përmbi ballë, balluke”. *Çka e ke lshue bulkën ashtu* (Çka i ke lshu balluket ashtu)? Fjalë me burim të diskutueshëm.

Cabu,-ni emër m. “kalliri i misrit”. *Kishte mbgje:ll ni kallambajš shum cabunin e madh e kishte* (Kishte mbjellë një misër që kishte kallirin shumë të madh). Nuk ekzistojnë të dhëna për etimologjinë e kësaj fjale.

Ca:fk,-a emër f. “enë për të pirë ujë, e bërë prej metali ose plastike por që ka bisht”. *Ma mbush ni ca:fk uj* (Më mbush një tas ujë). Sipas prof. Qemal Muratit, kjo fjalë është me prejardhje sllave dhe rrjedh nga fjala **cevka**.^{xi}

Ce:z,-a emër f. “ceja e perit, kalemi i penjve”.^{xi} Në fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe, të Kolec Topallit, fjala **cezë**, është fjalë krahinore që ka kuptimin “enë me grykë të ngushtë e me lëfyt të hollë, ibrik, gjep”.

Cepeni:c,-a emër f. “dru i çarë përgjysmë ose në katërsh i bërë gati për tu djegur”. *I çajta da cepenica*. (Copëtova dru). Mendohet se është huazim nga gjuhët sllave, **цепеница**.

Ce:rg,-a emër f. “cergë, shtroje a mbulesë e punuar në vek dhe e bërë nga pëlhura të vjetra”. *Shtroje cergën mas tët mbërdhin komet*. (Shtro cergën mos të të ftohen këmbët). Burimi i kësaj fjale, është i diskutueshëm. Mund të ketë hyrë nga greqishtja, nga gjuhët sllave **цepra**, ose nga turqishtja, **çerge**.

Cingla:n folje. “cingëron”. Përdoret zakonisht për fëmijët që qajnë pa ndalur. *Veç cingllan gjith ditën, nuk i ndalet zoni* (Vetëm qan, cingëron gjithë ditën, nuk i ndalet zëri).

Çanak,-i emër m. “enë e thellë, e bërë zakonisht prej balte për të ngrënë gjellë; pjatë”. *Mbushma ni çanak gro:sh!* Më mbush një pjatë me fasule! Huazim nga turqishtja, **çanak**, enë dheu.

Çake,-ja emër f. “gotë e metalit me bisht për të pirë ujë a ndonjë lëng tjetër”. *E pina ni çake tomël* (Kam pi një tas me qumësht).

Çevre,-ja emër f. “lloj shamie e nuses, shami e qëndisur”. Huazim nga gjuha turke.

Çemerung,-a emër f. “pjesët që mbetën në enë kur shkrihet dhjami i mishit, xhigerë”. *Hongrëm terho:n me çemerunga* (Hëngrëm tërhanë me xhigerë). Supozohet se rrjedh nga fjala **çember**, cipë dhjami që mbështjell përbrendësat e bagëtisë. Huazim nga turqishtja **çenber** “napë e hollë me të cilën gratë mbulojnë kokën, me burim nga persishtja”.^{xi}

Dari,-ja emër f. “çejzi; paja e nuses që punon vajza deri sa është në shtëpinë e babës dhe e bën gati për në shtëpinë e burrit”. *Da shkujm ta shohim dari:n e nuses* (Do të shkojmë të shohim pajën e nuses). Huazim nga sllavishtja, **даровити, дарови** “dhurata”.

Dagësdash,-i emër m. “lojë më nëntë gurë”. Ky emërtim vjen nga turqishtja **dokuz taş**, që do të thotë nëntë gurë. Kjo lojë zakonisht luhet me kokrra të fasules dhe kokrra të misrit.

Dallak,-i emër m. Me këtë fjalë, në të kaluarën është emërtuar një lloj sëmundje e cila është manifestuar me fryrje të barkut, zgjerim dhe dukje të enëve të gjakut në lëkurë, në zonën e barkut.

dakti:s folje. “ndanë, shpërndanë, e jep dorë më dorë”. Kjo folje është me prejardhje turke dhe rrjedh nga fjala **dağıtılmış** që do të thotë shpërndaj. *U daktisën isant, nuk mbet asnja* (U shpërndanë njerëzit, nuk mbeti asnjë).

Dangallat folje. Ka kuptimin e foljes prishë, çrregullon. *U ka dangalla:t ka kryja* (Është prishë në kokë, në mendje). *E ka dangalla:t n'qytek* (E ka rrahur shumë, i ka dhënë shumë dajak). Është huazim prej turqishtes, **dangalak**, që do të thotë i pagdhendur. Edhe pse më shumë e hasim në formë të foljes, këtë fjalë e gjejmë edhe si emër **dangall, dangallatsh** “i pagdhendur”.

Diko:llt,-a emër f. “nën këmishë për gra, veshje e brendshme e grave”. Në të kaluarën janë bërë prej materialeve të bardha të pambukut dhe janë veshur nën fustane apo veshje tjera të femrave. Është huazim nga frëngjishtja **decollete** “pjesa e sipërme e një fustani me jakë shumë të hapur”.

Dyndyrek,-i emër m. “lloj vegle në formë të konit e bërë prej druri që shërben për të luajtur”. Kjo lojë luhet me kamxhik. Mbështillet kamxhiku përreth dyndyreku dhe e hedh për t’a vënë në rrotullim. Përderisa dyndureku rrotullohet, goditet me kamxhik me qëllim që të mos ndalojë se rrotulluari. *Dët vërtiti si dyndyrek* (Do të të rrotulloj shumë shpejtë). Është huazim nga turqishtja që ka të njëjtin kuptim.

Du:js emër m. “që i vihen kalit ose gomarit për të ngarkuar diçka; duqe; hejbe”. *E ngarkoj kalin me dy pal dujs* (E ngarkoi kalim me dy palë duqe). Është fjalë shumë e vjetër që e kanë përdorur edhe Budi edhe Bardhi.

Ekle:me,-ja emër f. “fije të leshit a perit që u shtohen gërshetave që të duken më të trashë; tufë flokësh si bishtalec”. *Sën i lidhi fjokët pa ekleme* (S’ mundem t’i lidh flokët pa ekleme). Është fjalë që ka hyrë nga turqishtja, **eklemek** “shtoj, plotësoj”.

Exhinde,-ja emër f. “xhind; figurë që ka fuqi të mbinatyrshme mbi njerëzit dhe sendet; qenie të padukshme që u bëjnë dëm njerëzve”. *Exhinet e natës* (Xhindët e natës). *Ka shkelë në exhine* (Ka shkelë në xhind). Fjalë me prejardhje arabe.

Fërka:llk,-a emër f. “spec i tharë e i shtypur me kripë; kripë speci; biber i shtypur”. *Da ha buk me fërka:llk* (Do të ha bukë me kripë speci). Mund të lidhet me fjalën **fërkat**, **fërkas**, të cilën Çabej e merr si huazim sllav (maq.) **frka** “ther, shpoj, (skr.) **frkati** “përdredh, rrotulloj”.^{xi}

Fino:shk,-a emër f. “grua dyfytyrëshe; hipokrite”. *Ishte fino:shk grue* (Ishte grua dyfytyrëshe, hipokrite). Në fjalorin etimologjik, gjetëm vetëm variantin në gjininë mashkullore **finok** “njeri dinak, njeri i keq”.

Franxhull,-a emër f. “bukë e bardhë dhe e butë si shkumë”. *I ban bu:kt e mira, franxhull* (I bën bukët e mira, shkumë të buta). Mendohet se rrjedh nga fjala turke **francala** “lloj buke e bardhë në formë të zgjatur”.

Frra:çk,-a emër f. “lloj shpendi me pendë të zeza e me sqep të kthyer, sorrë”.

Furrik,-i emër m. “çerdhe zogjsh; fole”. *Dallëndyshkat jan tu e mbarue ni furrik* (Dallëndyshet janë duke e bërë një fole).

Ga:çk,-a emër f. “tregim për fëmijë, përrallë”. Fjalë shpotitëse. *Gjithë dimnit, babaqak na mblidhte krejt cullve edhe na diftonte gaçka* (Gjithë dimrit, babagyshi na mblidhte të gjithë fëmijëve dhe na tregonte përralla). Në fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe, kjo fjalë ka një kuptim krejtësisht tjetër, lakër e bardhë, kokë lakre. Edhe Çabej këtë fjalë e nxjerr nga fjala **graçkë**, “lakër e bardhë”.

Galiç ndajfolje. “me gjunjë të përkulur e duke u mbështetur mbi thembra, në bisht”. Rri (qëndroj) galiç. Ulet galiç, “i zhveshur, pa rroba”. Huazim nga gjuhët sllave, *гол* „i zhveshur”.

Gamul,-i emër m. “shkop, bastun”. Nuk kemi gjetur të dhëna për etimologjinë e kësaj fjale.

Giseni:c-a emër f. “vemje, krimb, krimb mëndafshi, krimba që hanë gjethet e pemëve”. *Mu ka nxhi:t si gisenic* (Më është ngjitur pas si vemje). Është fjalë me prejardhje sllave **гусеница** „vemje, krimb”.

Gilibit folje. “qëron, heq pjesë të lëvores a lëkurës, dëmton lëkurën”. *U ka rrzue, e ka gilibit ballin* (Është rrëzuar, e ka gërvishtë ballin).

Grazi:t folje. “gërdi, krupë, që të bën të vjellësh, të ngjall neveri”. *Ka ngro: ajś shu:m baklla:v sa u ka grazi:t* (Ka ngrënë aq shumë bakllava sa u ka gërditë).

Gri:ll,-i emër m. “rërë, zall, gurë të vegjël që zakonisht gjenden përreth detit a liqenit, gurë që sjell lumi me vete”. Fjalë me shtrirje krahinore në të dy dialektet.

Gri:sh folje, “Fton, i bën thirrje dikujt, i bën ftesë”. *E gri:shi për darsë:m* (E ftoi për dasmë). Fjalë e mbarë shqipes.

Gru:tk/a, emër f. “copë dheu që ngre plugu kur çanë tokën, plis dheu, nyje”. *E bona lavrën po shu:m grutka kishte* (E bëra lavrën por kishte shumë plisa dheu). *Mu ka bo ni gru:tk n’fyt, është tu ma zon frymën* (Më është bërë një nyje në fyt, është duke ma zënë frymën). Fjalë me prejardhje sllave **гpyтка** “bucë, plis dheu, top”.

Gulugutk,-a emër f. “dredhëz mali, luleshtrydhe me fruta të imëta që rriten vetëm në mal”. Fjalë me etimologji të panjohur.

Gorb,-a emër f. “lloj shpendi, sorrë, korb”. *E kishin ngro:n gorbat* (E kishin ngrënë korbat).

Golle,-ja emër f. “vrinë, gropë brenda në një të trup të ngurtë (në një dru, në një shkëmb etj)”. *Gollja e drurit. Hyri në golle.* ^{xi}

Gude,-ja emër f. “femra e derrit, dosa”. Përdoret gjatë ofendimeve. *Gudemonka kaurrit* (Dosa e shkaut).

Guruçu:p,-a emër f. “lojë me pesë guralecë”. Është luajtur në të kaluarën, zakonisht periudhën e dimrit kur fshatarët nuk kanë pasur punë bujqësie. *Kimi luejt guruçup edhe i kum mund krejt* (Kemi luajtur lojën me guraleca dhe i kam mundur të gjithë). Fjalë shqipe e formuar nga fjala **gur**.

Gumu:çk,-a emër f. “vend i fryrë dhe i fortë në trup, xhungë, bullungë, nyje”. *Mu ka bo ni gumu:çk n’krye* (Më është bërë një xhungë në kokë).

Gjerguni:c,-a, emër f. “gruaja e cila sapo ka lindur e deri në katërdhjetë ditë pas lindjes, lehonë”. Kjo fjalë mendohet se rrjedh nga fjalët **djerg, dirgjem**.

Hamamxhik,-i emër m. “banjë e vogël shtëpie”. Kjo banjë e vogël, bëhej në një skaj të dhomës, dhe përdorej për t’u larë. Kur nuk ishte në përdorim, ajo mbulohej me dërrasa dhe mbi të viheshin shtrojat e dhomës. Është fjalë me burim nga turqishtja, *hamamcık* “banjë e vogël shtëpie”.

Hulli, hylli,-ni emër m. “yll, trup qiellor”. *Ishte e hishme, hulli drite* (Ishte e bukur, yll drite). Fjalë e mbarë shqipes.

Hulluva:jk,-a emër f. “lloj shpendi, qyqe, kukuvajkë”. Grua që ka mbetur e vetme, pa familje.

Huno:z,-a emër f. “unazë, rreth i vogël prej ari, argjendi a prej ndonjë metali tjetër, që vihet në gisht si stoli në shenjë të lidhjes bashkëshortore”. *I kishte bgjet huno:z alltoni* (I kishte blerë unazë ari).

Ho:nx,-a, emër f. “hëna”. *E kishte ftyrën si honxa pesmdhiet* (E kishte ftyrën si hëna pesembëdhjetë).

Jalli,-a emër f. “yndyra në gjellë”. Është huazim nga turqishtja **yali**, por që ka kuptim “breg deti a lumi”. *Jemeki paska shumë jalli* (Gjella paska shumë yndyrë).

Japashërma emër f. “karficë me tri lira që kanë përdorë gratë si stoli në veshmbathje ose në flokë”. *Ari nuse lule me japashërma*. (këngë). Është huazim nga turqishtja **yapıştırmak** “ngjitë”.

Jark,-a emër f. “pulë e re që ende nuk ka filluar të bëjë ve, zogëz”. Huazim nga gjuhët sllave **јарица, јаричка**.^{xi}

Jezit,-i emër m. “njeri i keq, i djallëzuar”. Huazim nga turqishtja **yezid**, me burim prej arabishtes, prej emrit të Jezidit, udhëheqës i dinastisë Umajade, që urdhëroi vrasjen e pjesëtarëve të familjes së Imam Aliut. *Mas u ban jezit* (Mos u bë i keq).^{xi}

Kajruk,-i emër m. “bistek, gërshetë”. Emër me prejardhje nga turqishtja, **kuyruk**, “bisht”. *I kishte lidh fjakët kajruk* (Flokët i kishte lidhë gërshetë).

Kale:pk,-a emër f. “djep”. Fjalë me prejardhje nga gjuhët sllave, **колевка**. *E përkunda n'kale:pk edhe e zu žumi*. (E përkunda në djep dhe e zuri gjumi).

Kaptaj, folje kaptoj “kapërcej, dal në anën tjetër, “perëndon dielli, hëna). *Ka kaptue dilli* (Ka perënduar dielli). Kjo fjalë ka një përdorim më të gjerë në dialektin toskë, por e kemi hasur edhe në disa të folme gege siç është rasti me të folmen që kemi për studim.

Kapçit,-i emër m. “kafshatë, copë”. *Kapçita-kapçita* (copë copë). *Ma ep ni kapçit bu:k* (Më jep një kafshatë bukë). Vjen nga fjala kafshatë e cila në të folme të ndryshme, del me forma të ndryshme: *kafshatë, kapshatë, kafshitë, kapshitë*.

Kashtavi:n,-a emër f. “kashta e misrit”. Rjedh nga emri kashtë, që është fjalë e mbarë shqipes. *E thyem kallambojsin, kan mbet veç kashtavinat* (E thyem misrin, ka mbete vetëm kashta).

Kazhni:c/a emër f. “shportë e thurur me thupra”. Është huazim sllav, **кошница** “shportë”. *E kum mbush ni kazhni:c me šuršija* (E kam mbushë një shportë me qershë).

Kërçmë,-a emër f. “gosti, gosti me rastin e përfundimit të një pune në bujqësi”. Fjalë me prejardhje sllave, **крчма**. *Ja dham kërçmën punës* (E përfunduam punën).

Kukavi:c,-a emër f. “qyqë”. Huazim sllav, **кукавица**. *Pa ngjoje si kundan kakaviça* (Pa dëgjo si këndon qyqja).

Likty:r,-a emër f. “disa thupra të njoma që përdoren për të lidhur duaj ose dru. Është huazim nga latinishtja, **ligatura** “lidhje”. *Boni hazër liktyrat, t'i lidhim duejt* (Bëni gati lidhëset që t'i lidhim duajt).

Llazi:nk,-a emër f. “lozë e kungullit, lozë e bostanit”. Fjalë me prejardhje nga gjuhët sllave, **лозинка** “lozë”.

Maçek,-i emër m. “maçok”. Huazim nga sll. **mačak, mačok** “mace”.

Marmalug,-a emër f. “gatesë me miell gruri e me gjalpë, përvëlak”. Bëhet si kaçamaku, por me miell gruri. Toskërishtja e ka mëmëligë. Pasi që ky ushqim hahet me lugë, “marr me lugë”, edhe fjala marmalugë mund të ketë prejardhje nga kjo shprehje.

Meshu:nk,-a, emër f. “boçi i misrit pa kokrra”. Huazim sllav, **мешунка** “fasule e njomë, bishtajë”.

Miskrro:nj,-a emër f. “milingonë, mizë trualli që rron nën tokë e në dru”. Nuk kemi gjetur të dhëna për etimologjinë e kësaj fjalë. *U paska mbu:sh vendi krejt miskrronja* (Vendi qenka mbushë gjithë milionгона).

Mule:rk,-a emër f. “mushkonjë, kandërr e vogël pickuese që rron në moçalishte”. *Ktu verës ka shu:m mulerka* (Gjatë verës këtu ka shumë mushkonja). Nuk e kemi hasur në të folmet tjera geqe, prandaj edhe etimologjia e kësaj fjale është e panjohur.

Ndrape:t folje “shumë i lodhur, i rraskapitur”. *Kishte ndrapetën mo* (Ishte lodhur shumë). Nuk kemi gjetur të dhëna për etimologjinë fjalës.

Pajaçi:n/-a emër f. “rrejt merimange”. Fjalë me prejardhje sllave, **паяжина** “pëlhurë e merimangës”.

Pestil,-i, emër m. “lëng kumbullash i tharë e i bërë si petë”. Huazim prej turqishtes që ka hyre edhe në gjuhë tjera.

Pila:rk/a emër f. “dërrasë me bisht që shërben për të rrahur rrobat ku i lajmë”. Supozojmë të jetë huazim sllav për shkak të ngjashmërisë me fjalën me po të njëjtin kuptim **пиражка, перажка**.

Prasanik/i emër m. “pite misri e gatuar vetëm me ujë, kripë dhe miell”

Qena:r,-i emër m. “rrethi i ndonjë sendi a ndonjë vendi, cep, skaj”. Huazim nga turqishtja, **kenar**, me burim prej persishtes. *Hec për qenari mas të shkëlin arabët* (Hec në skaj të rrugës mos të të shkëlin makinat).

Qinqane emër f. “veshje grash si brekushe të gjata”. Në fjalorin etimologjik gjendet si *çitjane*.

Fjalë e toskërishtes; e vjetruar. Huazim prej turqishtes **çintiyān**, që ka hyrë edhe në gjuhët tjera ballkanike.^{xi}

Reshedie,-a emër f. “ëmbëlsirë që përgatitet me nisheste, gjalpë dhe sheqer; hasude”. Fjalë me përhapje krahinore, kryesisht në jug; e vjetruar. Huazim nga turqishtja, **rişidiye**, me burim prej arabishtes.

Ro:n,-a emër f. “vërshim, uji së bashku me rërën dhe gurët që barten gjatë reshjeve të mëdha të shiut”. Lidhet me fjalën ra:n, ron: “rërë”.

Rragzina emër f. “copa prej leshi që mbathen mbi opinga që mos rrëshqitet në borë ose baltë”

rrapatashkë,-a emër f. “druri që troket mbi gurët e mullirit për të rënë kokrrat e drithit në vrimën e gurit”. Është një krijim me elementin *rrap* “dru, hu, tra” dhe *tak* me burim onomatopeik. *I ban goja si rrapatashkë*. (Flet shumë).

Rrozgë,-a emër f. “grimca shumë të imëta të gurit, pluhurit a metalit”. *M’ka hy:p ni rro:zg n’sy* (Më ka hyrë një bërllok në sy). Në fjalorin etimologjik të Kolec Topallit, kjo fjalë ka një kuptim krejt tjetër. “degë e thatë që përdoret për zjarr, rrëzajë, lëmishte, mbeturinë; vend me shkurre, me ferra e me dru të thatë; drurë të kalbur”. Huazim nga sll. rozga “degë”.^{xi}

Saxhak,-i emër m. “këmbje, trekëmbësh për të vënë enët mbi zjarr”. Huazim prej turqishtes **sacayağı** “këmba e saçit”.

Shekël,-a emër f. “enë druri si fuqi e vogël për të mbajtur bulmet, turshi”. Kjo fjalë është shumë fjalë e vjetër shqipe pasi në këtë formë është përdorë edhe te Buzuku. *Shekla e turshive*.

Shushulake,-t emër f. “lëvozhgat e misrit, të drurit, të qepëve”, fig. njeri mendjelehtë.

Tevety:r emër m. “fjalë të shumta që thuhën poshtë e lartë, zhurmë që bëhet për një njeri a një çështje, shoshitje e fjalëve”. Huazim nga turqishtja **tevatür** me burim prej arabishtes.

A i kini tevety:r mir kta pu:n (A i keni shoshitë mirë këto punë)?

Thnegël/a emër f. “milingonë, mizë dheu”. Fjalë e trashëguar nga fondi indoevropian, e dëshmuar edhe te Bogdani.^{xi}

Ujem/i emër m. “mielli ose drithi që i jepej mullisit për bluarjen e drithit”. Huazim nga gjuhët sllave **yjam, yjem**. *Dy thas drith i lash ujem* (Dy thasë me drith i lashë si pagesë).

Ulurushk,-a emër f. “vajtore, vajtuese; gra që vajtojnë të vdekurit”. Kjo fjalë rrjedh nga fjala *uluran* (ulëron, qan, bërtet me zë). Në disa fshatra të kësaj zone dialektore, kemi hasur edhe fjalën *hulluva:jk* (vajtore).

Valavi:c,-a emër f. “valavicë, dërstilë, vegël që shërben për të shkelur, shtypur zhgunin”.

Vërlo:shk,-a emër f. “lëvore drurësh a pemësh; lëvozhga”.

Xhërxhalen,-i emër m. “gjinkallë, lloj kandrrë që këndon në vapë, që lëshon në vapë një zë të zgjatur e gumëzhitës”. Kjo fjalë lidhet me fjalën onomatopeike *xhërr-xhërr*, të gjinkallës. *Sat kundonte xhërxhaleni, është nxehët* (Sot këndonte gjinkalla, është nxehtë).

Zelenike,-ja emër f. “lloj shkurreje shumëvjeçarë; lat. *buxus sempervirens*”. Huazim nga maqedonishtja **зеленика** “bushe, shimshir”.

žarpizni emër.m “gjarpërinj”. Kjo fjalë paraqet shumësin e fjalës *gjarpër*. Është me rëndësi të ceket se këtë formë e shumësit, *žarpizni*, e kemi hasur vetëm tek fshatrat e arealit gjuhësor të Rekës së Epërme.

Përfundim:

Duke u mbështetur në studimet e kryera në fushë të leksikut nga studiues të tjerë dhe në rezultatet e arritura gjatë punës sonë në terren, mund të përfundojmë se e folmja shqipe e Rekës së Epërme dhe e fshatrave me origjinë nga kjo krahinë, ruan shumë fjalë të rralla e të vjetra shqipe të cilat rrallë pak ose aspak nuk përdoren në të folmet e tjera shqipe.

Për shkak të studimeve të pamjaftueshme dhe botimeve të pakta të fjalorëve krahinorë, nuk kemi mundur që të zbardhim etimologjinë e disa fjalëve rekase, të cilat nuk i kemi gjetur në fjalorin etimologjik.

Kemi hasur shumë fjalë të përbashkëta me të folmet toske. Shumë forma të vjetra të fjalëve shqipe që datojnë nga koha e Budit, Buzukut e Bogdanit. Për të vërtetuar këto lidhje, nevojiten studime më të thelluara, me mbledhje më të plota të materialit leksikor, ndërsa materiali i paraqitur, do të shërbejë si një pikënisje për këto kërkime.

Dhe në fund, është detyrë e jona që ne si lëvruet të gjuhës t’i rrekemi punës për studime të reja etnosociolinguistike për Rekën e Epërme dhe rekasit e saj të shpërngulur, t’i nxjerrim në dritë visaret e rralla të kësaj zone shqipfolëse dhe t’ia bashkëngjitem thesarit të madh të gjuhës shqipe, për t’i ruajtur e për t’i zhvilluar ato edhe më tej.

Bibliografia

- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Botimet Toena, Tiranë, 2002.
- Haruni, Sejfedin, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup.
- Idrizi, Xhemaludin, *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, edicioni i dytë, Shkup, 2017.
- Murati, Qemal, *Hulumtime linguistike dhe kulturo-historike në etnoregjonin e Rekës së Epërme*, Shkup, 2016.
- Murati, Qemal, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, ITSHKSH, Shkup, 2015.
- Murati, Qemal, *Fjalor i sllavizmave në të folmet shqiptare të Maqedonisë*, Albas, 2004.
- Myxhahid Korça, *Fjalor shqip - turqisht / türkçe – arnavutça*, Logos A, 2009.
- Nopça, F. B, Doda, E. B, *Jeta e fshatarëve shqiptarë në Grykën e Rekës së Epërme, Dibra e Madhe, Maqedoni*. Evropa 92, Koçani, 2015.
- Sinani, Idaete, *Veçoritë leksikore të fshatrave Krushopek, Gërçec dhe Nerez të Shkupit* (punim magjistrature në dorëshkrim i mbrojtur më 2016).
- Topalli, Kolec, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2017.
- Ymeri, Haki, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.
- Ymeri, Haki – Osmani Zihni, *Fjalor maqedonisht-shqip*, Logos-A, Shkup, 2000.
- Ymeri, Haki – Bina, *Fjalor shqip maqedonisht*, Logos-A, Shkup, 2012.